

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

15-06 2017

P.nr.815/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtar ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.222-1-2017 të dt 31.03.2017, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPK-së duke vendosur sipas kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.12.05.2017 mori:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.222-1-2017 e dates 31.03.2017, dhe gjykata shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] i lindur me datë [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ema [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR] me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 10.02.2017, rreth ores 17:30 në rrugën lokale të fshatit Dardani, Ferizaj i pandehuri nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerezve dhe pasurive, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 42 pika.1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë, derisa drejtonte automjetin e tipit "VW Golf", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] ngjyre hiri, në drejtim të rrugës Ferizaj – Gjilan, me të arritur në fshatin Dardani fillon kthimin në anën e majte, nga rruga kryesore në atë dytesore "Shaban Rashit Topalli", duke mos u siguruar se me një veprim të tillë nuk i rrezikon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, goditet me pjesën e përparme nga automjeti tipit "BMW", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilën e drejtonte i dëmtuari [REDAKTUAR], ku në atë moment ishte duke levizur në kahje të kundërt, i njëjti në pjesën e përparme të anës së majte të automjetit, godet në pjesën e anës së djathtë të automjetit të tipit "WV Touran" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilin e drejtonte i dëmtuari [REDAKTUAR] i cili ishte ndalur për të kyçur në rrugën Ferizaj – Gjilan, nga rruga dytesore e fshatit [REDAKTUAR], me ç'rast si pasojë e aksidentit, përveç dëmeve materiale në automjet, lëndime të lehta trupore kanë pësuar të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me pasojë të perkohshme për shëndetin,

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së

Gjykata konform nenit 463 par.1 lidhur me par 3.të KPPK-së [REDACTED] [REDACTED] ga fshati [REDACTED], Viti dhe [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 90,88 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.815/17/2017 i dt.12.05.2017

Zyrtari Ligjor
Burim Haxhidema

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të dërgesës së njëjtë, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotëfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.